

# Prokurori Arben Qosja përballet me pyetje për pagesat e kësteve të apartamentit

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit evidentoi pamundësi financiare në pagesat e dy kësteve për blerjen e një apartamenti në Tiranë, ndërsa prokurori i Apelit të Tiranës, Arben Qosja tha se apartamenti ishte pasuria e vetme e familjes së tij dhe se ishte blerë me burime të ligjshme.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Prokurori i Apelit të Tiranës, Arben Qosja gjatë seancës dëgjimore me KPK. Foto: Edmond Hoxhaj.

Prokurori i Apelit të Tiranës, Arben Qosja u përball të hënën me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Procesi i vetingut për prokurorin Qosja po kryhet nga trupa e përbërë nga Genta Tafa Bungo kryesuese, Lulzim Hamitaj relator dhe Suela Zhegu anëtare. Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar ishte i pranishëm Ferdinando Buatier.

Arben Qosja e ka filluar karrierën në sistemin e drejtësisë në vitin 1998 si oficer i Policisë Gjqësore. Në vitin 2004, Qosja u emërua prokuror në Prokurorinë e Tiranës, ndërsa prej vitit 2016 e ushtron funksionin në Prokurorinë e Apelit të Tiranës.

Relatori Lulzim Hamitaj tha në seancën dëgjimore se prokurori Qosja rezultonte në pamundësi financiare për shlyerjen e dy kësteve për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 90.86 m<sup>2</sup> në Tiranë në vitin 2005, kundrejt vlerës 53 mijë euro. Gjithashtu,

Komisioni konstatoi se Qosja kishte deklaruar shlyerjen e paradhënies në vlerën 10 mijë euro në vitin 2005, por nuk kishte pasqyruar detyrimin e mbetur.

Hamitaj shpjegoi se në kontratën fillestare, vlera e apartamentit shënohej 59 mijë euro, ndërkohë që në vitin 2006, prokurori e kishte deklaruar ndryshimin e çmimit në shumën 53 mijë euro për shkak të zvogëlimit të sipërfaqes së apartamentit në 83 m<sup>2</sup>.

Si burime krijimi të kësaj pasurie, Qosja ka deklaruar një hua në vlerën 20 mijë euro të marrë në vitin 2006 pa interes dhe pa afat; 3.8 milionë lekë nga shitja e një apartamenti nga nëna e tij dhe kursime nga pagat.

Sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në vitin 2005 pagesën e 25 mijë eurove në favor të shoqërisë ndërtuese si dhe shlyerjen e 16 mijë eurove në vitin 2006.

Hamitaj shpjegoi se në analizën financiare nuk është përfshirë e gjithë vlera 3.8 milionë lekë e deklaruar si e përfituar nga nëna e subjektit nga shitja e apartamentit, pasi në kontratën e shit-blerjes ka figuruar shuma 2 milionë lekë. Sipas tij, nuk është përfshirë vlera 1.8 milion lekë që përfaqëson diferencën mes çmimit të deklaruar me atë të pasqyruar në kontratën e shit-blerjes.

Ndërkohë, nuk janë gjetur probleme lidhur me huanë 20 mijë euro, pasi huadhënësi ka rezultuar të ketë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme dhe nuk është evidentuar konflikt interesi mes tyre.

Në përfundim të analizës financiare për këtë pasuri, Komisioni konstaton mungesë të burimeve financiare në vlerën 850 mijë lekë për pagesën e këstit të parë dhe pamundësi në shumën 900 mijë lekë për pagesën e këstit të dytë.

Prokurori Arben Qosja deklaroi gjatë seancës dëgjimore se kishte dhënë edhe më parë shpjegime lidhur me çdo gjetje të Komisionit për mosmbulimin e dy kësteve për shlyerjen e çmimit të apartamentit.

Ai kërkoi që KPK të vlerësonte të ardhurat e gjithë familjarëve që prej vitit 1998.

“Edhe pse nuk janë pasqyruar kursimet në deklaratën periodike, vërtetohen burimet e ligjshme të cilat janë të mjaftueshme për kursimet. Nuk mund të përligjet mospërfshirja e mundësisë së kursimeve për këstin e parë,” tha Qosja dhe vijoi se në deklaratën veting kishte pasqyruar burimin e ligjshëm që kishte shërbyer për shlyerjen e këtij detyrimi.

Lidhur me konstatimin për pamundësi të shlyerjes së këstit të dytë, Qosja shpjegoi se shitja e apartamentit ishte kryer nga nëna.

“Pas pagesës së tatimit për vlerën reale të përfituar nga shitja e këtij apartamenti, duhet përfshirë gjithë kjo shumë në analizën financiare”, kërkoi Qosja.

Ai shtoi se në deklaratën veting kishte pasqyruar detyrimin e mbetur pa paguar dhe se gjithçka ishte e sqaruar.

Ka dokumente se vlera reale e shitjes është tërhequr nga nëna në bankë dhe të nesërmen është paguar kësti i dytë. “Gjykoj se nuk ka vend për balancë negative,” tha prokurori Qosja.

I pyetur nga Hamitaj se përse nuk e ishte shlyer më parë detyrimin tatimor për vlerën 1.8 milionë lekë, Qosja ripërsëriti se shitja e apartamentit të mëparshëm ishte kryer nga nëna dhe se ai kishte qenë në pamundësi të kryente korigjimin. Sipas subjektit të rivlerësimit, pas shitjes, blerësit e kishin vendosur këtë pasuri si barrë hipotekore dhe se kjo e bënte të pamundur për këtë palë që të paraqitej para noterit.

“Pala blerëse e ka deklaruar se çmimi i shitjes ishte 3.8 milionë lekë. Nuk ka patur gjë për të fshehur”, pohoi Qosja dhe këmbënguli se kishte qenë gjithmonë kritik ndaj veprimet të kryer lidhur me vlerën e shitjes në kontratë, ndryshe nga ajo reale.

Komisioni konstaton mosdeklarimin periodik të një magazine në Peshkopi, që figuron në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit, e përfituar nëpërmjet privatizimit në vitin 1992. Hamitaj sqaroi se Qosja ka pretenduar se nuk kishte kryer mosdeklarim të kësaj pasurie, pasi trualli ku gjendet magazina figuron ende me pronar “shtet” dhe se u ishte përmbajtur dokumenteve ligjorë në deklaratimet e tij.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se prokurori Qosja ka pasur mundësi financiare për blerjen e një autoveture tip Volksäagen në vitin 2013, kundrejt vlerës 5670 euro + 162 mijë lekë për detyrimet doganore. Edhe për likuiditetet e tij e të bashkëshortes nuk janë gjetur probleme.

Hamitaj tha se nga analiza financiare e kryer prej vitit 2004, kur Qosja ka nisur detyrën si prokuror e në vazhdimësi, bilanci mes të ardhurave dhe shpenzimeve rezulton përgjithësisht pozitiv.

Sipas Komisionit, mbeten negative balancat për shlyerjen e dy kësteve për apartamentin, përkatësisht 850 mijë lekë në vitin 2005 dhe 900 mijë lekë në 2006-ën.

Qosja pranoi se në deklaratimet e para kishte pasur paqartësi dhe pasaktësi. “Por, nuk ka ndonjë qëllim pas tyre”, theksoi ai.

Prokurori Qosja u vlerësua pozitivisht për figurën dhe profesionalizmin. Edhe për një çështje për “drejtim të automjetit në mënyrë të parregullt” të verifikuar nga KPK, për të cilën Qosja kishte vlerësuar se vendimi i Shkallës së Parë kishte qenë i rregullt dhe nuk kishte ushtruar rekurs, nuk u evidentuan probleme. Hamitaj tha se prokurori Qosja kishte njoftuar me shkrim drejtuesin e Prokurorisë së Apelit për qëndrimin e tij. “Komisioni i vlerëson në përputhje me detyrën këto veprime të subjektit”, tha Hamitaj dhe shtoi se në 5 denoncimet e kryera nga publiku nuk janë gjetur indicie.

Në përfundim të seancës dëgjimore, prokurori Arben Qosja tha se në punën e tij 30 vjeçare si prokuror dhe oficer i Policisë Gjyqësore, gjithmonë e kishte ushtruar detyrën me përgjegjësi dhe në korrektësi me ligjin. Ai shpjegoi se kishte filluar punë si prokuror në vitin 1991 dhe se kishte rifilluar në ‘98-ën si oficer i Policisë Gjyqësore.

“E gjithë pasuria e familjes sime, së bashku me prindërit është 53 mijë euro dhe justifikohet ligjshmëria e saj. Gjykoj se i plotësoj të tri kriteret e rivlerësimit për të vazhduar detyrën dhe kërkoi konfirmimin,” përfundoi prokurori Arben Qosja.

KPK njoftoi se do të shpallë vendimin më datë 21 tetor, ora 09:45.



**RRETH AUTORIT**

### **Edmond Hoxhaj**

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.